

Vendim nr. 29 datë 05.02.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Genti Ibrahim, Anëtar
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 05.02.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (Gj) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GJERGJ GJINI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 21, datë 01.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 209, datë 13.10.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-1109, datë 13.06.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gjergj Gjini është proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprat penale të tentativës së vrasjes me paramendim, kanosjes dhe

mbajtjes pa leje të armëve shpërthyesë dhe municionit, të parashikuara nga nenet 78, pika 1, 22, 84 dhe 278, pika 1, të Kodit Penal (KP).

2. Gjatë seancës paraprake, kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të tij, bazuar në nenet 332/c dhe 403 – 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka kërkuar gjykimin e shkurtuar të çështjes. Në përfundim të seancës paraprake, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë (gjyqtari i seancës paraprake), me vendimin nr. 287, datë 23.03.2021, ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me tjetër trup gjykues.

3. Gjykata e caktuar për gjykimin e çështjes në themel, pasi ka dëgjuar mbrojtësin e kërkuesit, i cili ka pohuar se i qëndron kërkesës për gjykim të shkurtuar, ka vendosur mospranimin e saj, bazuar në nenin 405, pika 7, të KPP-së. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 21, datë 01.02.2022, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij për veprat penale të kanosjes, plagosjes së rëndë me dashje dhe mbajtjes pa leje të armëve shpërthyesë dhe municionit, të parashikuara nga nenet 84, 88 dhe 278/1 të KP-së, duke i caktuar, bazuar në nenin 55 të të njëjtit kod, një dënim të vetëm të bashkuar prej 12 vjetësh burgim.

4. Ndonëse kërkuesi dhe prokuroria kanë paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 209, datë 13.10.2022. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1109, datë 13.06.2024, ka vendosur mospranimin e rekurseve, me arsyetimin se nuk përmbanin shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

5. Në datën 12.11.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.12.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* të lidhur me *parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi në shkelje të ligjit procedural penal atij i është rrëzuar kërkesa për gjykim të shkurtuar nga gjykata e shkallës së parë edhe pse ajo është paraqitur në formën dhe afatin e kërkuar nga ligji. Kërkuesi është invalid me status të përhershëm dhe për shkak të mospranimit të kërkesës po vuan një dënim më të gjatë. Gabimi nuk është korrigjuar nga gjykata e apelit dhe as nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit, me një vendim konfuz, nuk ka pranuar të shqyrtojë rekursin e kërkuesit, duke mos i dhënë përgjigje pretendimeve të tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji vëren se kërkueti legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi kundërshton vendimet gjyqësore me të cilat është dënuar për akuzat penale, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkueti i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i takon kriterit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkueti ka përfunduar me vendimin e datës 13.06.2024 të Gjykatës së Lartë, i cili sipas informacionit të kësaj të fundit, është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 25.09.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 02.12.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e zakonshme kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, pasi, në kundërshtim me ligjin, praktikën gjyqësore, kushtetuese dhe evropiane, i kanë refuzuar atij kërkesën për gjykim të shkurtuar, edhe pse ajo ishte paraqitur nga kërkuesi në formën dhe afatin e kërkuar nga ligji, duke i mohuar kështu uljen e masës së dënimit, për rrjedhojë kërkuesi po vuan një dënim më të gjatë. Kjo mangësi, sipas tij, nuk është riparuar as nga gjykata e apelit, as nga Gjykata e Lartë. Gjykata e shkallës së parë, nga njëra anë, nuk e ka pranuar gjykimin e shkurtuar dhe, nga ana tjetër, gjatë gjykimit të zakonshëm nuk ka marrë prova të reja. Kjo mangësi nuk është konstatuar as nga gjykata e apelit, as nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit nuk e ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit, duke mos i dhënë përgjigje pretendimit të tij.

13. Duke mbajtur në konsideratë thelbin e argumenteve të kërkuesit, Kolegji çmon ta analizojë çështjen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e mosdënimit pa ligj, të garantuar nga nenet 42 dhe 29 të Kushtetutës.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 42, datë 29.05.2024; nr. 9, datë 27.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Lidhur me gjykimin e shkurtuar në procesin penal, Gjykata ka pranuar se ai nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit dhe në rast se ai ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që të rrëzojë kërkesën e të pandehurit (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret Kolegji vëren se ashtu siç pretendon edhe kërkuesi, ai e ka paraqitur kërkesën për gjykim të shkurtuar në formën dhe afatin e parashikuar nga neni 403, pika 1, i KPP-së nëpërmjet mbrojtësit të tij me autorizim gjatë seancës paraprake. Megjithatë, gjykata e shkallës së parë nuk ka vënë në dyshim përmbushjen e kritereve të formës dhe afatit, por i është referuar pikës 7 të nenit 405 të KPP-së, sipas së cilës kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet nëse i pandehuri apo mbrojtësi i tij ngrenë pretendime për vlefshmërinë e akteve apo përdorshmërinë e provave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak apo kur kërkojnë marrjen e provave të reja në gjykim. Po sipas këtij neni, kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet edhe në rastet kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmëri absolute apo papërdorshmëri të provave, si rezultat i të cilave çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen e akteve. Mbi bazën e këtij parashikimi ligjor, gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar, duke theksuar se kërkuesi dhe mbrojtësi i tij, njëkohësisht me kërkesën për gjykim të shkurtuar, kanë kërkuar pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, urdhërimin e prokurorisë të kryejë hetime shtesë, si dhe ndryshimin e akuzës. Madje, në përfundim të gjykimit me procedurë të zakonshme, gjatë të cilit janë shqyrtuar prova të reja, gjykata e shkallës së parë e ka ndryshuar një prej akuzave, atë të tentativës së vrasjes me paramendim në plagosje të rëndë me dashje.

18. Në aktin e apelit kërkuesi ka ngritur edhe pretendimin për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, pretendim i cili është gjetur i pabazuar nga gjykata e apelit. Kjo e fundit ka arsyetuar se kërkesa për gjykim të shkurtuar është shoqëruar me disa kërkesa të tjera, si në seancë paraprake, ashtu dhe gjatë gjykimit të themelit, duke e përmbysur kështu kuptimin material që mbart në vetvete kjo kërkesë, gjykimin e çështjes në gjendjen që janë aktet. Ajo gjykatë, ka konstatuar se: (i) në seancën paraprake të datës 23.03.2021 kërkuesi dhe mbrojtja e tij përveç kërkesës për gjykim të shkurtuar (deklaruar në seancë), kanë paraqitur edhe dy kërkesa me shkrim, përkatësisht për pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe ndryshimin e cilësimit të veprës penale në ngarkim të kërkuesit; (ii) gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur se fashikulli i gjykimit duhet të përmbante të gjitha aktet e ndodhura në dosjen penale, me përjashtim të deklarimeve të bëra nga dy shtetas, të cilat ishin të papërdorshme dhe duhet t'i ktheheshin prokurorit; (iii) referuar procesverbalit të pyetjes së të pandehurit të datës 24.02.2021, ka rezultuar se kërkuesi nuk ka dëshiruar të deklarojë gjë në

atë fazë hetimi, duke rezervuar të drejtën për t'u shprehur në seancë gjyqësore; (iv) në seancën gjyqësore të gjykimit në themel të çështjes të datës 11.05.2021, kërkuesi dhe mbrojtësi i tij, krahas kërkesës për gjykim të shkurtuar kanë kërkuar edhe pavlefshmërinë e akteve; (v) gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar kërkesën duke vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, referuar pretendimeve të palëve në proces, si dhe gjatë gjykimit janë marrë prova të reja, siç janë ekspertimi psikiko-ligjor dhe prova me dëshmitarë. Sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë ka konkluduar me të drejtë se në kushtet kur kërkuesi ka kundërshtuar aktet e fashikullit të hetimit, duke kërkuar pavlefshmërinë e tyre dhe duke kërkuar një kualifikim ndryshe të veprës penale, si dhe në kushtet kur vetë gjyqtari i seancës paraprake ka konstatuar pavlefshmëri të akteve të hetimit, kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk gjen zbatim në rastin konkret, për rrjedhojë nuk e ka pranuar as në atë fazë të gjykimit (*shih faqet 22-25 të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër*).

19. Kërkuesi e ka ngritur këtë pretendim edhe në rekurs. Në vendimin e mospranimit të rekursit Gjykata e Lartë është shprehur, ndër të tjera, se vendimi për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar ishte i drejtë dhe i argumentuar (*shih paragrafin 25 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat kanë vepruar në përputhje me dispozitat procedurale penale që kanë qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar. Gjyqtari i seancës paraprake, në ushtrim të kompetencës së tij funksionale, ka përcjellë fashikullin e gjykimit, së bashku me kërkesën për gjykim të shkurtuar në gjykatën që do të shqyrtonte çështjen në themel. Disponimi për pranimin ose refuzimin e kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar në atë moment procedural e ka pasur gjyqtari i caktuar për gjykimin e çështjes në themel (para ndryshimeve të KPP-së me ligjin nr. 41/2021), ndërkohë që gjyqtari i seancës paraprake kontrollonte plotësinë e hetimeve, nëse ka akte të pavlefshme apo papërdorshmërinë e provave, nevojën për marrjen e provave të reja. Edhe gjatë gjykimit në themel, i gjykuari ka parashtruar kërkesa/prendime për pavlefshmëri të akteve të hetimit paraprak, ndaj gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt nenin 405 pika 7, të KPP-së, që përcakton shprehimisht se kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet nëse i pandehuri ose mbrojtësi i tij ngrenë pretendime për pavlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave të hetimit paraprak. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka evidentuar se gjatë gjykimit të çështjes janë marrë prova të reja, si dhe ka pasur edhe disponim mbi papërdorshmërinë e provave të caktuara. Në këto rrethana e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatave të faktit për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar (*shih paragrafin 26 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

20. Në vështrim të sa më sipër, Kolegji vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vendimet e tyre kanë dhënë arsyetim bindës dhe shterues se përse procedura e shqyrtimit gjyqësor të çështjes nga gjykata e shkallës së parë, si gjykim i zakonshëm, ka qenë e

domosdoshme, për shkaqe që lidheshin me kundërshtimet e kërkuarit për vlefshmërinë e akteve dhe nevojën për marrjen e provave të reja. Kolegji vlerëson se vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit, në këto rrethana Kolegji arrin në përfundimin se gjykatat e zakonshme kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe se në refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar nuk rezulton që ato të kenë bërë një arsyetim arbitrar, në kuptimin e gabimeve faktike ose ligjore, ndaj masa e dënimit të kërkuarit nuk ka vënë në dyshim as parimin kushtetues të mosdënimit pa ligj.

21. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e procesit të rregullt ligjor, në aspekt të cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e mosdënimit pa ligj, është haptazi i pabazuar.

22. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuarit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.